



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 164

Tiranë – E Hënë, 27 Tetor 2014

PËRMBAJTJA

Faqe

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 668, datë 15.10.2014	Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për programet e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”/“Master i Arteve të bukura”, për vitin akademik 2014 – 2015.....	8285
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 15.10.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 122, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e madhe e Tiranës (Komuna e Parisit - Rruga e Kavajës)””.....	8297
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 672, datë 15.10.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza veriore Korçë (Dritat e verdha - kryqëzimi, rruga Korçë - Kapshticë) shtesat”.....	8299
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 673, datë 15.10.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By-pass Plepa - Kavajë - Rrogozhinë, rrugët dytësore nga ana e hekurudhës (loti 1 dhe 2)”.....	8300
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 674, datë 15.10.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Gramsh - Lozhan (ura Kodovjat-Moglicë)”.....	8301
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 675, datë 15.10.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza lindore Shkodër”.....	8304
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 676, datë 15.10.2014	Për përcaktimin e formatit dhe të elementeve të njoftimit për barrën siguruese dhe/ose hipotekore.....	8306

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 677, datë 15.10.2014	Për dhënien e bursave për nxënësit e shkollës së mesme profesionale “Peter Mahringer”, Shkodër, për vitin shkollor 2014 – 2015.....	8308
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 678, datë 15.10.2014	Për miratimin e projektit pilot për masat për nxitjen e të nxënit, vijueshmërisë dhe përparimit të nxënësve romë dhe egjiptianë të shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Korçë, për vitin shkollor 2014-2015.....	8309
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 679, datë 15.10.2014	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Margarita Xhepa.....	8310
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 680, datë 15.10.2014	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Margarita Qirko.....	8310
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 681, datë 15.10.2014	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Luljeta Kopliku.....	8310
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 683, datë 15.10.2014	Për dhënien e pëlqimit për krijimin e shoqërisë aksionare, ndërmjet Federatës Shqiptare të Rafting dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.....	8311
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 684, datë 15.10.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 419, datë 14.4.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e afateve dhe të skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar.....	8311
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 685, datë 16.10.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 552, datë 27.8.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e garancisë qeveritare, të lëshuar në favor të Bankës Tregtare, Raiffeisen Bank Albania, në kuadër të kushteve të kontratës së kredisë që do të nënshkruhet ndërmjet kësaj banke dhe KESH, sh.a.-së”.....	8312
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 693, datë 22.10.2014	Për krijimin e Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara.....	8314
Kërkesë e Ministrisë së Kulturës nr. 4750, datë 16.10.2014	Kërkesë për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Ndërtimi i një Muzeu të Bashkëjetesës”.....	8315

**VENDIM****Nr. 668, datë 15.10.2014**

**PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE
TARIFAT E SHKOLLIMIT NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË
ARSIMIT TË LARTË PËR PROGRAMET
E STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË ME
KOHË TË PLOTË, “MASTER
PROFESIONAL” DHE “MASTER I
SHKENCAVE”/“MASTER I ARTEVE TË
BUKURA”, PËR VITIN AKADEMIK 2014 -
2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 24, 34, 35, 36 e 75, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye ose për shkak të detyrës”, si dhe të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe të Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e përgjithshme të pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2014 - 2015, në programet e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, “Master Profesional”, janë 6 393 (gjashtë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tre) kuota gjithsej, të ndara, si më poshtë vijon:

- | | |
|--------------------------------------|-------|
| a) Kuota për pranimet e reja | 6243; |
| b) Kuota për program të dytë studimi | 60; |
| c) Kuota për transferim studimesh | 60; |
| ç) Kuota për shtetasit e huaj | 30. |

2. Kuotat e pranimeve të reja, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij vendimi, përbëhen nga:

- | | |
|---|-------|
| a) Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit | 5823; |
| b) Kuota për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit | 250; |
| c) Kuota për të verbrit | 15; |
| ç) Kuota për romët dhe ballkano-egjiptianët | 15; |
| d) Kuota për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë | 15; |
| dh) Kuota për jetimët | 15; |
| e) Kuota për ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë | 110. |

3. Kuotat e përgjithshme të pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2014 - 2015, në programet e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, “Master i Shkencave” dhe “Master i Arteve të Bukura”, janë 6547 (gjashtë mijë e pesëqind e dyzet e shtatë) kuota gjithsej, të ndara, si më poshtë vijon:

- | | |
|---------------------------------------|-------|
| a) Kuota për pranimet e reja | 6397; |
| b) Kuota për program të dytë studimi; | 60; |
| c) Kuota për transferim studimesh | 60; |
| ç) Kuota për shtetasit e huaj | 30. |

4. Kuotat e pranimeve të reja, sipas shkronjës “a”, të pikës 3, të këtij vendimi, përbëhen nga:

- | | |
|---|-------|
| a) Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit | 6087; |
| b) Kuota për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit | 250; |
| c) Kuota për të verbrit | 15; |
| ç) Kuota për romët dhe ballkano - egjiptianët | 15; |
| d) Kuota për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë | 15; |
| dh) Kuota për jetimët | 15. |

5. Kuotat e pranimit në programet e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” apo “Master i Arteve të Bukura”, të parashikuara përkatësisht në shkronjat “a”, të pikave 2 dhe 4, të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimit në institucionet publike të arsimit të lartë, pasqyrohen përkatësisht në tabelat nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Kuotat e pranimit për një program të dytë studimi, si dhe kuotat për transferim studimesh në programet e studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” apo “Master i Arteve të Bukura”, të përcaktuara përkatësisht në shkronjat “b” dhe “c”, të pikave 1 dhe 3, të këtij vendimi,



shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, mbështetur dhe në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

7. Kandidatët, që kanë përfunduar me sukses një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi, brenda numrit të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit, sipas kriterëve të përcaktuara nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë për pranimet në një program të dytë studimi dhe rregullave të parashikuara në këtë vendim.

8. Transferimet e studentëve në numrin përkatës të kuotës bëhen bazuar në udhëzimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe sipas kriterëve të meritës, të përcaktuara nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë dhe në këtë vendim.

9. Studentët transferojnë studimet nga një program i ngjashëm studimi i mëparshëm “Master Profesional” në një program tjetër studimi “Master Profesional” apo nga një program studimi “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve të Bukura” në një program tjetër studimi “Master i Shkencave” apo “Master i Arteve të Bukura”, në institucionet publike të arsimit të lartë, duke iu nënshtruar tarifës për kredit të programit të studimit, në të cilin ata kanë kërkuar të transferojnë studimet, të përcaktuar në tabelat nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

10. Kuotat e pranimeve për shtetasit e huaj, të përcaktuara përkatësisht në shkronjat “ç”, të pikave 1 dhe 3, të këtij vendimi, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Ato shpërndahen në bazë të marrëveshjeve dy- apo shumëpalëshe, si dhe në bazë të kërkesave individuale, të paraqitura në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit nga personat e interesuar.

11. Kuotat e pranimit në programet e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” apo “Master i Arteve të Bukura”, të parashikuara përkatësisht në shkronjat “b”, të pikave 2 dhe 4, të këtij vendimi, shpërndahen me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë. Rishpërndarja e këtyre kuotave kryhet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë.

12. Kandidatët nga Republika e Kosovës, Republika e Maqedonisë, Republika e Malit të Zi

dhe nga Prefektura e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës aplikojnë direkt në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Specifikime të tjera për mënyrën e aplikimit, si dhe kriteret e vlerësimit dhe të pranimit të tyre në këto programe studimi përcaktohen me udhëzim të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe bëhen të njohura në median e shkruar dhe elektronike për të gjithë kandidatët e interesuar.

13. Kuotat e pranimit për të verbrit, të përcaktuara përkatësisht në shkronjën “c”, të pikave 2 dhe 4, të këtij vendimi, për romët dhe ballkano - egjiptianët, të përcaktuara në shkronjën “ç”, të pikave 2 dhe 4, të këtij vendimi, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuara në shkronjën “d”, të pikave 2 dhe 4, të këtij vendimi, për jetimët, të përcaktuara në shkronjën “dh”, të pikave 2 dhe 4, të këtij vendimi, dhe për ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë, të përcaktuara në shkronjën “e”, të pikës 2, të këtij vendimi, ndahen ndërmjet kandidatëve me statusin përkatës nga një komision me përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të komisionit të përbashkët, si dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve përcaktohen me udhëzim të ministrit të Arsimit dhe Sportit. Rishpërndarja e këtyre kuotave kryhet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë.

14. Studentët, që do të aplikojnë për të vazhduar studimet në një program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” apo “Master i Arteve të Bukura” apo kërkojnë të transferojnë studimet e tyre, duhet të kenë notë mesatare të studimeve të ciklit të parë më të lartë se nota gjashtë, si dhe notë mesatare të të gjitha viteve të shkollës së mesme më të lartë se nota gjashtë.

15. Çdo program studimi i ciklit të dytë me kohë të plotë, “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” apo “Master i Arteve të Bukura” fillon veprimtarinë akademike në vitin e parë, për vitin akademik 2014 - 2015, në rast se në këtë program studimi regjistrohen së paku 10 studentë. Ky rregull nuk aplikohet për Universitetin e Arteve, Tiranë.

Për programet e studimit, për të cilat janë



akorduar kuota për disa profile së bashku, institucionet publike të arsimit të lartë, në përfundim të aplikimeve, u komunikojnë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencisë Kombëtare të Provimeve programet e studimit me profilin përkatës, të cilat kanë numër studentësh mbi 10 dhe që do të fillojnë rishtazi veprimtarinë akademike në vitin akademik vijues.

16. Institucionet publike të arsimit të lartë përcaktojnë kriteret e pranimit të kandidatëve të rinj për programet e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” apo “Master i Arteve të Bukura”, për vitin akademik 2014 - 2015, dhe i bëjnë publike, paraprakisht, përpara datës së parashikuar për fillimin e aplikimeve në këto programe studimi.

17. Tarifat e shkollimit për kredit për studentët që do të regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” apo “Master i Arteve të Bukura”, në vitin akademik 2014 - 2015, pasqyrohen përkatësisht në tabelat nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

18. Paga e tarifës për të gjitha programet e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” apo “Master i Arteve të Bukura”, bëhet me këste të përcaktuara nga institucioni publik i arsimit të lartë. Kësti i parë parashikon pagesën në masën 30% të tarifës totale dhe paguhet menjëherë me regjistrimin e studentit në programin përkatës të studimit.

Pas përfundimit të kohëzgjatjes normale të programit të studimit, studentët, të cilët nuk e kanë përfunduar ende programin përkatës dhe nuk kanë shlyer të gjitha provimet e parashikuara në atë program studimi deri në përfundim të vitit akademik, konsiderohen studentë ngelës/përsëritës.

Për lëndët përsëritëse, studentët paguajnë çdo vit akademik dyfishin e tarifës për kredit të parashikuar në këtë vendim.

Përcaktimi i sipërpërmendur do të aplikohet për vitin akademik 2014 -2015 e në vazhdim, gjithashtu edhe për të gjithë studentët e regjistruar në vitet akademike të mëparshme, të cilët nuk kanë përfunduar programet përkatëse të studimeve dhe do të jenë përsëritës.

19. Shtetasit e huaj, që do të vazhdojnë studimet e ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur, në kuadër të marrëveshje ndërshtetërore, është parashikuar ndryshe.

20. Studentët, që transferojnë studimet në një program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” apo “Master i Arteve të Bukura”, në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen tarifës për kredit për program të dytë studimi, sipas tabelave nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi, për lëndët e mbetura në programin e studimit përkatës, në të cilin ata kanë kërkuar të transferojnë studimet.

21. Kuotat e përcaktuara rishpërndahen nga ministri i Arsimit dhe Sportit, në varësi të prioriteteve dhe politikave shtetërore në arsimin e lartë. Kuotat e përcaktuara dhe të pashpërndara deri në 16.12.2014 nuk mund të rishpërndahen më.

22. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



TABELA Nr. 1

KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË "MASTER PROFESIONAL", PËR VITIN AKADEMIK 2014 - 2015

EMERTIMI I UNIVERSITETIT	ID_PROGRAMIT	EMERTIMI I PROGRAMIT	Kuotat e pranimi për kandidatët brenda territorit të vendit	Tarifa për kredit për program të parë studimi	Tarifa për kredit për program të dytë studimi
Universiteti i Tiranës	1	Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Histori	100	1,000	1,200
Universiteti i Tiranës	2	Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Gjeografi	110	1,000	1,200
Universiteti i Tiranës	3	Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Gjuhë - Letërsi	130	1,000	1,200
Universiteti i Tiranës	4	Arkivistikë	50	1,000	1,200
Universiteti i Tiranës	5	Redaktori	45	1,000	1,200
Universiteti i Tiranës	6	Guidë turistike	25	1,000	1,200
Universiteti i Tiranës	7	Informatikë Biznesi	80	1,100	1,320
Universiteti i Tiranës	8	Inxhinieri Matematike dhe Informatike	30	1,100	1,320
Universiteti i Tiranës	9	Teknologji Informacioni	60	1,100	1,320
Universiteti i Tiranës	10	Punë Sociale e Avancuar (2 Dejte)	40	1,100	1,320
Universiteti i Tiranës	11	Analizë e Politikës Sociale	40	1,100	1,320
Universiteti i Tiranës	12	Qeverisja dhe Politikat Publike	50	1,100	1,320
Universiteti i Tiranës	13	Administrim i Institucioneve Sociale në Sistemin e Drejtësisë	80	1,100	1,320
Universiteti i Tiranës	14	Filozofi Praktike dhe Humane	15	1,100	1,320
Universiteti i Tiranës	15	Këshillim Psikologjik	30	1,100	1,320
Universiteti i Tiranës	16	Orientim Profesional	30	1,000	1,200
Universiteti i Tiranës	17	Drejtim dhe Administrim Arsimi	25	1,100	1,320
Universiteti i Tiranës	18	Pedagogji e Specializuar Sociale	25	1,100	1,320
Universiteti i Tiranës	19	Administrim - Biznes	40	1,200	1,440
Universiteti i Tiranës	20	Administrim - Publik	40	1,200	1,440
Universiteti i Tiranës	21	Marketing dhe Marrëdhënie me Publikun	40	1,200	1,440
Universiteti i Tiranës	22	Menaxhim Turizmi	40	1,200	1,440
Universiteti i Tiranës	23	Financë	100	1,200	1,440
Universiteti i Tiranës	24	Kontabilitet	60	1,200	1,440
Universiteti i Tiranës	25	Studime Ekonomike Evropiane	40	1,200	1,440
Universiteti i Tiranës	26	Sisteme Informacioni në Ekonomi	50	1,200	1,440
Universiteti i Tiranës	27	E Drejtë Civile	50	1,000	1,200
Universiteti i Tiranës	28	E Drejtë Penale	50	1,000	1,200
Universiteti i Tiranës	29	E Drejtë Publike	50	1,000	1,200
Universiteti i Tiranës	30	Biznes Law	100	1,000	1,200
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	31	Shëndet Publik	30	1,200	1,800
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	32	Menaxhim Infermieror	150	1,200	1,800
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	33	Mami	35	1,200	1,800
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	34	Teknikë Laboratori	35	1,200	1,800
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	35	Fizioterapi	25	1,200	1,800
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	36	Teknikë Imazherie	25	1,200	1,800
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	37	Geriatri	20	1,200	1,800
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	38	Logopedi	20	1,200	1,800
Universiteti Bujqësor i Tiranës	39	Arkitekturë peisazhi	15	1,200	1,440
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	40	Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Lartë në Gjuhë - Letërsi, me profil minor në "Arte"	100	1,000	1,200
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	41	Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Lartë në Gjuhë angleze, me profil minor në "Arte"	30	1,000	1,200
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	42	Mësuesi në Histori - Gjeografi	40	1,000	1,200
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	43	Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Shkenca Sociale	40	1,000	1,200



EMERTIMI I UNIVERSITETIT	ID. PROGRAMIT	EMERTIMI I PROGRAMIT	Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit	Tarifa për kredit për program të parë studimi	Tarifa për kredit për program të dytë studimi
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	44	Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Matematikë - Fizikë, me profil minor në "Informatikë"	30	1,000	1,200
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	45	Biologji-Kimi	30	1,000	1,200
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	46	Teknologji Informacioni	30	1,000	1,200
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	47	Infermieristikë	80	1,000	1,500
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	48	Financë - Kontabilitet	85	1,000	1,200
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	49	Menaxhim	40	1,000	1,200
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	50	Marketing	40	1,000	1,200
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	51	Turizëm	50	1,000	1,200
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	52	Zhvillim i Integruar Rural	45	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	53	Menaxhim, me profil Menaxhim Biznesi	50	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	54	Ekonomi - Biznes, me profil Financë - Bankë	50	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	55	Menaxhim, me profil Marketing	25	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	56	Sigurim Jete, jo Jete dhe Sigurimet Detare	15	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	57	Ekonomi - Biznes, me profil drejtim i SME-ve	15	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	58	Mësimdhënie e Gjuhës Angleze	40	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	59	Didaktikë	55	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	60	Shërbime Sociale dhe Komunitare	15	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	61	Infermieri Kirurgjikale	27	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	62	Politika dhe Administrim, me profil "Administrim Publik"	54	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	63	Politika dhe Administrim, me profil "Drejtim Turizmi"	15	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	64	E Drejtë e Pronës	15	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	65	E Drejtë Detare	15	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	66	Shkenca Kompjuterike të Aplikuara	40	1,000	1,200
Universiteti Politeknik i Tiranës	67	Inxhinieri Ndërtimi	60	1,100	1,430
Universiteti Politeknik i Tiranës	68	Inxhinieri Mjedisi	40	1,100	1,430
Universiteti Politeknik i Tiranës	69	Inxhinieri Hidroteknike	25	1,100	1,430
Universiteti Politeknik i Tiranës	70	Inxhinieri Gjeodezi	25	1,100	1,430
Universiteti Politeknik i Tiranës	71	Automatizim Industrie	23	1,100	1,430
Universiteti Politeknik i Tiranës	72	Elektroenergjitikë	23	1,100	1,430
Universiteti Politeknik i Tiranës	73	Inxhinieri Mekatronike	23	1,100	1,430
Universiteti Politeknik i Tiranës	74	Inxhinieri Matematike në Analiza Sistemes	30	1,100	1,430
Universiteti Politeknik i Tiranës	75	Inxhinieri Fizike në Mjekësi	25	1,100	1,430
Universiteti Politeknik i Tiranës	76	Transport	15	1,100	1,430
Universiteti Politeknik i Tiranës	77	Energjitikë	10	1,100	1,430
Universiteti Politeknik i Tiranës	78	Inxhinieri Materiale	10	1,100	1,430
Universiteti Politeknik i Tiranës	79	Inxhinieri Gjeologjike (5 profile)	74	1,100	1,430
Universiteti Politeknik i Tiranës	80	Inxhinieri e Burimeve Natyrore (4 profile)	76	1,100	1,430
Universiteti Politeknik i Tiranës	81	Inxhinieri Gjeomjedisi	16	1,100	1,430
Universiteti Politeknik i Tiranës	82	Inxhinieri Informatike	35	1,100	1,430
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	83	Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në Gjuhë - Letërsi	20	1,000	1,200
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	84	Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në Histori dhe Gjeografi	20	1,000	1,200
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	85	Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në Biologji - Kimi	20	1,000	1,200
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	86	Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në Matematikë - Fizikë	20	1,000	1,200
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	87	Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në Matematikë - Informatikë	15	1,000	1,200



EMERTIMI I UNIVERSITETIT	ID_PROGRAMIT	EMERTIMI I PROGRAMIT	Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit	Tarifa për kredit për program të parë studimi	Tarifa për kredit për program të dytë studimi
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	88	Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në Edukim fizik dhe Sporte	65	1,000	1,200
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	89	Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në Gjuhë angleze	20	1,000	1,200
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	90	Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në Gjuhë italiane	14	1,000	1,200
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	91	Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në Gjuhë frënge	14	1,000	1,200
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	92	Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në lëndët Gjuhë gjermane	14	1,000	1,200
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	93	Matematikë - Fizikë, me profil minor "Informatikë"	15	1,000	1,200
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	94	Informatikë, me profil minor në "Matematikë"	15	1,000	1,200
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	95	Matematikë, me profil minor në "Informatikë"	15	1,000	1,200
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	96	Histori - Gjeografi, me profil minor në "Edukim qytetar"	15	1,000	1,200
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	97	Administrim Publik	50	1,000	1,200
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	98	Sipërmarrje dhe turizëm	15	1,000	1,200
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	99	Financë	50	1,000	1,200
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	100	Kontabilitet	25	1,000	1,200
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	101	Marketing	15	1,000	1,200
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	102	Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Informatikë	30	1,000	1,200
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	103	Studime të Avancuara Detare	30	1,000	1,200
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	104	Operacione Industriale dhe Navale	15	1,000	1,200
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	105	Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në Matematikë - Fizikë	15	1,000	1,200
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	106	Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në Gjuhë angleze	45	1,000	1,200
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	107	Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në Gjuhë italiane	15	1,000	1,200
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	108	Mësuesi për Ciklin e Ulët me profil minor "Parashkollor"	60	1,000	1,200
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	109	Shkenca Administrative	35	1,000	1,200
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	110	Infermieri Patologjike	45	1,000	1,300
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	111	Infermieri Kirurgjikale	35	1,000	1,300
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	112	Infermieri Pediatrike	15	1,000	1,300
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	113	E Drejtë Penale	50	1,000	1,200
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	114	Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në Matematikë - Fizikë	20	1,000	1,200
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	115	Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në Matematikë - Informatikë	15	1,000	1,200
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	116	Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në Biologji - Kimi	20	1,000	1,200
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	117	Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në Gjuhë - Letërsi	60	1,000	1,200
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	118	Mësuesi, për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në Gjuhë angleze	20	1,000	1,200
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	119	Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në Histori - Gjeografi	55	1,000	1,200
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	120	Kontabilitet - Financë	70	1,000	1,200
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	121	Administrim Publik	45	1,000	1,200
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	122	Turizëm	20	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	123	Teknologjitë e Informacionit	45	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	124	Analist Prodhimi	20	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	125	Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Matematikë - Fizikë me profil minor në "Informatikë"	55	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	126	Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Biologji - Kimi, me profil minor në "Edukim Shëndetësor dhe Mjedisor"	65	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	127	Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë e Huaj Anglisht, me profil minor në "Gjuhë Shqipe"	65	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	128	Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë e Huaj Frengjisht, me profil minor në "Gjuhë Shqipe"	30	1,000	1,200



EMERTIMI I UNIVERSITETIT	ID. PROGRAMIT	EMERTIMI I PROGRAMIT	Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit	Tarifa për kredit për program të parë studimi	Tarifa për kredit për program të dytë studimi
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	129	Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë e Huaj Italisht, me profil minor në "Gjuhë Shqipe"	30	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	130	Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë e Huaj Gjermanisht, me profil minor në "Gjuhë Shqipe"	20	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	131	Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në Gjuhë - Letërsi	35	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	132	Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Histori - Gjeografi, me profil minor në "Edukatë Qytetare"	70	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	133	Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Edukatë Qytetare - Histori, me profil minor në "Gjeografi"	40	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	134	Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në Edukim Fizik dhe Sporte	50	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	135	Psikologji në Institucione	25	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	136	Punë Sociale me Fëmijët dhe Familjen	15	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	137	Shërbimi i Provës	45	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	138	Administrim - Biznes	60	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	139	Marketing	20	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	140	Financë	50	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	141	Kontabilitet	20	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	142	Ekonomia dhe e Drejta në Sektorin Publik	60	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	143	Informatikë Ekonomike	20	1,000	1,200
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	144	Infermieri Kirurgjikale	45	1,000	1,500
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	145	Menaxhim Infermieror	65	1,000	1,200
Universiteti i Sporteve të Tiranës	146	Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Edukim Fizik	110	1,000	1,500
Universiteti i Sporteve të Tiranës	147	Stërvitje Sportive	30	1,000	1,500
Universiteti i Arteve, Tiranë	148	Kitarë	5	1,420	2,130
Universiteti i Arteve, Tiranë	149	Fizarmonikë	4	1,420	2,130
Universiteti i Arteve, Tiranë	150	Studim Bastube	1	1,420	2,130
Universiteti i Arteve, Tiranë	151	Pedagogji Muzikore	10	1,420	2,130
		TOTALI	5,823		



TABELA Nr. 2

KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË “MASTER I SHKENCAVE”/ “MASTER I ARTEVE TË BUKURA”, PËR VITIN AKADEMIK 2014 - 2015

EMERTIMI I UNIVERSITETIT	ID_PROGRAMIT	EMERTIMI I PROGRAMIT	Kuotat e pranimi për kandidatët brenda territorit të vendit	Tarifa për kredit për program të parë studimi	Tarifa për kredit për program të dytë studimi
Universiteti i Tiranës	1	Gjuhësi e Sotme	30	1,250	1,500
Universiteti i Tiranës	2	Gjuhësi Historike	20	1,250	1,500
Universiteti i Tiranës	3	Studime Letrare (3 drejtime)	35	1,250	1,500
Universiteti i Tiranës	4	Histori	35	1,250	1,500
Universiteti i Tiranës	5	Marrëdhënie Ndërkombëtare	35	1,250	1,500
Universiteti i Tiranës	6	Trashëgimi Kulturor	15	1,250	1,500
Universiteti i Tiranës	7	Arkeologji	15	1,250	1,500
Universiteti i Tiranës	8	Gjeografi	50	1,250	1,500
Universiteti i Tiranës	9	Gazetari dhe Komunikim	100	1,250	1,500
Universiteti i Tiranës	10	Biologji Mjedisore	15	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	11	Biologji Molekulare	15	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	12	Fizikë	20	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	13	Bioteknologji Molekulare dhe Industriale	30	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	14	Kimia Industriale dhe Mjedisore	40	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	15	Inxhinieri e Procese Kimike	30	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	16	Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore	50	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	17	Kimi	24	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	18	Inxhinieri Matematike dhe Informatikë	15	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	19	Informatikë	60	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	20	Matematikë	15	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	21	Mësues AML në Kimi	50	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	22	Mësues AML në Biologji	60	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	23	Mësues AML në Fizikë	30	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	24	Mësues AML në Matematikë	60	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	25	Teknologji Informacioni	35	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	26	Gjuhë dhe Komunikim Ndërkulturor dhe Turistik	120	1,250	1,500
Universiteti i Tiranës	27	Përkthim Teknik-Letrar dhe Interpretim	100	1,250	1,500
Universiteti i Tiranës	28	Mësuesi AM në Gjuhë Angleze	120	1,250	1,500
Universiteti i Tiranës	29	Mësuesi AM në Gjuhë Italiane	60	1,250	1,500
Universiteti i Tiranës	30	Mësuesi AM në Gjuhë Frënge	50	1,250	1,500
Universiteti i Tiranës	31	Mësuesi AM në Gjuhë Gjermane	50	1,250	1,500
Universiteti i Tiranës	32	Përkatesi Gjimore dhe Zhvillim	30	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	33	Administrim i Çështjeve Sociale	30	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	34	Shërbime Sociale në Drejtësinë Penale	30	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	35	Çështje të Fëmijëve dhe të Familjes	30	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	36	Komunikim për Ndryshim Social dhe të Sjelljes	20	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	37	Studime Rajonale Politike	40	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	38	Psikologji Shkollore	30	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	39	Psikologji Organizacionale	30	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	40	Psikologji Klinike	30	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	41	Filozofi Sociale	30	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	42	Teori Politike	30	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	43	Sociologji e Zhvillimeve Shoqërore	30	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	44	Punë Sociale (3 drejtime)	80	1,400	1,680



EMERTIMI I UNIVERSITETIT	ID_PRO GRAMIT	EMERTIMI I PROGRAMIT	Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit	Tarifa për kredit për program të parë studimi	Tarifa për kredit për program të dytë studimi
Universiteti i Tiranës	45	Mësuesi AM në Shkenca Sociale	50	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	46	Etika në Institucione dhe Lidership	30	1,400	1,680
Universiteti i Tiranës	47	Administrim Biznesi (2 profile)	40	1,750	2,100
Universiteti i Tiranës	48	Administrimit Publik	40	1,750	2,100
Universiteti i Tiranës	49	Marketing	40	1,750	2,100
Universiteti i Tiranës	50	Menaxhim Turizmi	20	1,750	2,100
Universiteti i Tiranës	51	Financë (3 profile)	80	1,750	2,100
Universiteti i Tiranës	52	Kontabilitet dhe Auditim	40	1,750	2,100
Universiteti i Tiranës	53	Ekonomiks	40	1,750	2,100
Universiteti i Tiranës	54	Sisteme Informacioni në Ekonomi	40	1,750	2,100
Universiteti i Tiranës	55	Kërkime Operacionale	25	1,750	2,100
Universiteti i Tiranës	56	Legjislacioni dhe Institucionet e BE	30	1,500	1,800
Universiteti i Tiranës	57	Politika dhe Qeverisja në Evropë	30	1,500	1,800
Universiteti i Tiranës	58	Diplomacia dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare	30	1,500	1,800
Universiteti i Tiranës	59	Drejtesi, me profil "E drejtë civile"	100	1,250	1,500
Universiteti i Tiranës	60	Drejtesi, me profil "E drejtë penale"	100	1,250	1,500
Universiteti i Tiranës	61	Drejtesi, me profil "E drejtë publike"	100	1,250	1,500
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	62	Shëndet Publik	15	1,750	2,625
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	63	Infermieri	150	1,750	2,625
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	64	Mami	40	1,750	2,625
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	65	Teknikë Laboratori	50	1,750	2,625
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	66	Fizioterapi	40	1,750	2,625
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	67	Teknikë Imazherie	40	1,750	2,625
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	68	Filozofi Sociale	25	1,250	1,500
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	69	Turizëm dhe Mikpritje	20	1,250	1,500
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	70	Financë	25	1,250	1,500
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	71	Mësuesi për Arsimin Fillor	45	1,250	1,500
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	72	Mjekësi e Bimëve	16	1,250	1,500
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	73	Administrim Biznesi	15	1,100	1,320
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	74	Pasuri e Paluajtshme	15	1,100	1,320
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	75	Financë	30	1,100	1,320
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	76	Ekonomiks	15	1,100	1,320
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	77	Shkenca Infermiore	20	1,100	1,320
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	78	Shkenca Kompjuterike	15	1,100	1,320
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	79	Inxhinieri Navale	20	1,100	1,320
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	80	Fizikë	15	1,100	1,320
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	81	Matematikë	15	1,100	1,320
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	82	Matematikë - Financë	15	1,100	1,320
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	83	Biologji Mjedisore	15	1,100	1,320
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	84	Mësuesi AML në Kimi	15	1,100	1,320
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	85	Ndërtim Makinash	15	1,100	1,320
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	86	Pedagogji e Specializuar Sociale	20	1,100	1,320
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	87	Marrëdhënie Ndërkombëtare	25	1,100	1,320
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	88	Mësimdhënie e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë	30	1,100	1,320
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	89	Përkthim	15	1,100	1,320
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	90	Edukim	30	1,100	1,320
Universiteti Politeknik i Tiranës	91	Inxhinieri Ndërtimi me profil Strukturist	30	1,750	2,275



EMERTIMI I UNIVERSITETIT	ID. PROGRAMIT	EMERTIMI I PROGRAMIT	Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit	Tarifa për kredit për program të parë studimi	Tarifa për kredit për program të dytë studimi
Universiteti Politeknik i Tiranës	92	Inxhinieri Ndërtimi, me profil "Infrastrukturë e transportit"	15	1,750	2,275
Universiteti Politeknik i Tiranës	93	Inxhinieri Mjedisi, me profil "Trajtim uji"	15	1,750	2,275
Universiteti Politeknik i Tiranës	94	Inxhinieri Mjedisi, me profil "Energjetikë"	15	1,750	2,275
Universiteti Politeknik i Tiranës	95	Inxhinieri Hidroteknike	25	1,750	2,275
Universiteti Politeknik i Tiranës	96	Inxhinieri Gjeodezi	20	1,750	2,275
Universiteti Politeknik i Tiranës	97	Inxhinieri Elektrike, me profil "Automatizimi i industrisë"	18	1,500	1,950
Universiteti Politeknik i Tiranës	98	Inxhinieri Elektrike, me profil "Energjetikë"	18	1,500	1,950
Universiteti Politeknik i Tiranës	99	Inxhinieri Fizike	15	1,400	1,820
Universiteti Politeknik i Tiranës	100	Inxhinieri Matematike	15	1,400	1,820
Universiteti Politeknik i Tiranës	101	Inxhinieri Mekanike, me profil "Konstruksion makinash dhe mjete lëvizëse"	20	1,200	1,560
Universiteti Politeknik i Tiranës	102	Inxhinieri Mekanike me profil Energjitikë	15	1,200	1,560
Universiteti Politeknik i Tiranës	103	Inxhinieri Mekanike, me profil "Prodhim dhe Menaxhim industrial"	10	1,200	1,560
Universiteti Politeknik i Tiranës	104	Inxhinieri Materiale, me profil Materiale	15	1,200	1,560
Universiteti Politeknik i Tiranës	105	Inxhinieri Tekstili dhe Mode	15	1,200	1,560
Universiteti Politeknik i Tiranës	106	Inxhinieri Ekonomike	40	1,200	1,560
Universiteti Politeknik i Tiranës	107	Inxhinieri Gjeologjike (4 profile)	20	1,300	1,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	108	Inxhinieri e Burimeve Natyrore (4 profile)	20	1,300	1,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	109	Inxhinieri Gjeofizike	12	1,300	1,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	110	Inxhinieri e Gjeomjedisit	10	1,300	1,690
Universiteti Politeknik i Tiranës	111	Inxhinieri Informatike	35	1,700	2,210
Universiteti Politeknik i Tiranës	112	Inxhinieri Telekomunikacioni	35	1,700	2,210
Universiteti Politeknik i Tiranës	113	Inxhinieri Elektronike	35	1,700	2,040
Universiteti Bujqësor i Tiranës	114	Inxhinieri Agromjedisit	30	1,700	2,040
Universiteti Bujqësor i Tiranës	115	Inxhinieri Agrare me profil Prodhimi Bimor	15	1,700	2,040
Universiteti Bujqësor i Tiranës	116	Inxhinieri Agrare me profil Hortikulturë	15	1,700	2,040
Universiteti Bujqësor i Tiranës	117	Inxhinieri Agrare me profil Zooteknik	15	1,700	2,040
Universiteti Bujqësor i Tiranës	118	Menaxhim i Kullimit, Ujitjes dhe Mekanizmit	15	1,700	2,040
